



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:184857

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05494741

**C.nr.2888/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësja F.B. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, av.N.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompanisë së Sigurimeve "PRISIG", në seli në Prishtinë, me objekt të kontestit Kompensime të dëmit, vlera e kontestit 1.000,00, jashtë seancës gjyqësore, me datën **22 Mars 2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-**

**I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditëses F.B. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve "PRISIG" me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material për gjitha lloje, paditëses t'ia paguajë shumën prej 1.750,00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 31.08.2023, e deri në pagesën definitive si dhe të detyrohet i padituri që ti paguajë shpenzimet procedurale.

**II.** Shpenzimet procedurale bien në barrë të paditëses .

**A r s y e t i m**

Paditësja F.B. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, av.N.M. nga Prizreni, ka parashtruar padi, kundër të paditurës kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "PRISIG" me seli në Prishtinë, si objekt kontesti kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 1.000.00 euro.

E autorizuar e paditëse av.N.M. nga Prizreni, me parashtrësën e datës 20.03.2023, e ka njoftuar gjykatën se me paditurën Kompania e Sigurimeve "PRISIG" me seli në Prishtinë, kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, dhe një kopje të

marrëveshjeje ja dorëzuar gjykatës, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 149, par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka heqë dorë nga padia dhe kërkesëpadia.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi që të njëjtat të bien në barr të palës paditëse.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 149.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), pa shqyrtim të mëtejshëm, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.2888/2023 datë 22 Mars 2024**

**Gjyqtari**

---

**Gëzim Shehu**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.